



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.05.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe votimi nën për nën dhe në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimit” (*komisioni përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Adelina Rista, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Shezai Rrokaj, Almira Xhembulla, Besnik Baraj.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Romeo Gurakuqi, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Musa Ulqini, Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Ervin Demo – Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Linda Pustina – Drejtore e Drejtorisë së Integritetit, Marrëveshjeve, Koordinimit dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë

Ejvis Gishti – Drejtore e Agjencisë së Kualifikimit, Aftësimit dhe Formimit Profesional

Nikoll Doçi – përfaqësues i sindikatave

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi!

Sipas kalendarit që miratuam në fillim të muajit maj, kemi rënë dakord për ta miratuar në parim ligjin “Për kornizën shtetërore të kualifikimeve”, kurse sot jemi mbledhur për ta diskutuar atë nen për nen.

Diskutimi i ligjit nen për nen bëhet pasi Komisioni i Ligjeve e ka përfunduar raportin dhe ia ka dorëzuar atë komisionit tonë. Përfaqësuesit e atij komisioni kanë bërë komentet e tyre për çdo nen, kurse ne kemi disa komente, që i ka depozituar zonja Malaj, e cila nuk është e pranishme sot në mbledhje për arsye objektive. Ndërkohë, nga pala jonë është caktuar relatore zonja Vilma Bello.

Të gjithë e kemi përpara raportin e Komisionit të Ligjeve. Ju keni qenë dje të pranishëm në Komisionin e Ligjeve. Raporti ishte bërë që javën e kaluar, por përfundoi dje. Mendoj se do të ishte mirë të kalonim në diskutimet nen për nen, sepse në parim kemi rënë dakord që ky është një ligj i domosdoshëm, sepse përafron kurrikulën tonë me kërkesat e Bashkimit European. Ramë dakord që ky ligj nuk ndryshon në thelbin e vet, por bën disa përmirësime në ligjin ekzistues, për të qenë i bashkërenduar me kornizën e BE-së, për më tepër kur kemi nevojë për një bashkëpunim rajonal, sepse edhe vendet e tjera të Ballkanit po punojnë për të bërë të njëjtën gjë.

Në qoftë se kemi komente, le t'i marrim nenet me radhë. Vazhdojmë me komentet e Komisionit të Ligjeve, komentet e zonjave Nora Malaj dhe Vilma Bello dhe, më pas, mirëpresim nëse dikush ka ndonjë ide për të shtuar.

Shezai Rrokaj – Nuk kemi pse i shikojmë nenet një për një, por të ndalemi vetëm atje ku ka probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Ka një sugjerim nga Komisioni i Ligjeve për të vendosur titujt e neneve 1 dhe 2, konkretisht “qëllimi” dhe “objekti”.

Jemi dakord me këtë propozim?

Në nenin 3 thuhet që nuk ka ndryshuar fare përmbajtja e nenit bazë. Rekomandohet që të bëhet më i plotë përshkrimi i nenit 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thuhet që përkufizimet duhet të renditen sipas rendit alfabetik.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, Muhamet.

Muhamet Bela – Unë mendoj se propozimet e bëra nga Komisioni i Ligjeve janë shumë të sakta dhe duhet të futen të plotë në përkufizime, sepse janë standardet e fundit të kornizës europiane.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kanë kaluar dje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ato japin propozimet të ligjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi edhe tre propozime të Norës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I keni marrë propozimet e Norës?

Vilma Bello – Dje u ra dakord me komentet dhe sugjerimet e komisionit. Lidhur me nenin 3, ne mund të punojmë për t'i vendosur sipas rendit alfabetik.

Milva Ekonomi – Dhe të plotësohet. Janë dy komente nga Komisionin i Ligjeve.

Vilma Bello – Në germën “m” ka ngelur lidhëza “ose”, e cila duhet hequr, duhet të jetë: “njohuri, aftësi dhe kompetenca” dhe të plotësohet ...

Milva Ekonomi – Komisioni i Ligjeve ka thënë këtë gjë: “Duke qenë se ka ndryshuar pothuajse e gjithë përmbajtja e nenit 3, në bazë të ligjit bazë, rekomandohet që përmbajtja e nenit 3 të jepet e plotë. Krahas sugjerimit të mësipërm, sugjerohet që përkufizimet të renditen sipas rendit alfabetik”.

Vilma Bello – Atëherë, duhet ta ndryshojmë komplet nenin 3, duke futur përveç këtyre që kemi bërë, edhe ato që janë në ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Terminologjia që është përdorur këtu përfshin të gjitha nivelet e edukimit. Terminologjia e AFP-së përfshin vetëm pjesën e arsimit profesional, ashtu sikurse terminologjia për arsimin e lartë përfshin vetëm arsimin e lartë. Ky është një ligj kuadër, që mbulon të gjitha nivelet. Do të thotë që përkufizimet duhet të mbulojnë të gjitha fushat. Përkufizimet janë pak a shumë të njëjta, por janë hartuar në mënyrë të tillë që të mos bien ndesh me ligjet e ndryshme.

Ismet Beqiraj – I bie që të ndryshohet ligji i vitit 2017.

Vilma Bello – Jo, në thelb përkufizimi nuk ndryshon.

Ismet Beqiraj – Këtë sugjerim ka bërë edhe Komisioni i Ligjeve, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Harmonizimin e tyre me terminologjinë e përdorur, thuhet edhe në ligjin nr.15\2017.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te rekomandimet për komisionin përgjegjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Komisioni i Ligjeve na e rekomandon neve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te faqja 4.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo vlen për nenin 3. Këtë sugjerim e ka edhe për nenin 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Të më falësh Ismet, që po shpjegoj!

Ne ramë dakord në parim që rekomandimet e Komisionit të Ligjeve t'i përfshijmë këtu. Deri te faqja 4, ramë dakord në parim që do të jenë.

Ky komision ka bërë edhe diskutimin nen për nen, pas diskutimit në parim. Ne i morëm në konsideratë rekomandimet në parim.

Tani po diskutojmë ndryshimet, që ata kanë propozuar nen për nen. Kemi shkuar deri te faqja 5.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, patjetër.

Ismet Beqiraj – Unë shoh që jemi të gjithë dakord. Shoh se kemi në tryezë 3 materiale. Kemi rekomandimet e Komisionit të Ligjeve, kemi një material nga Nora, e cila propozon disa ndryshime dhe rekomandimet e relatores. Le të merremi me këto, që t’u japim rrugë!

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Jam dakord, por le të vijojmë nën për nën!

Thamë që në nenin 3 do të bëjmë këto ndryshime.

Te neni 4, ata thonë se duhet të ndryshohet sipas ligjit bazë. Sugjerohet që pikat “d” dhe “dh” të këtij neni të unifikoheshin në një paragraf të vetëm me përmbajtjen: “Parimi i qartësisë”. Jemi dakord me këtë?

Neni 7 të ndryshohet në bazë të nenit 6 të ligjit bazë.

Po ashtu, kanë bërë disa rekomandime. Ata kërkojnë që parashikimet e këtij projektligji të harmonizohen me parashikimet e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, konkretisht me nenin 6, pika 9, nenin 17 dhe nenin 72, të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të RSH-së”. Ligji ka parashikuar të drejtën e IAL-ve, jo vetëm të universiteteve, për të ofruar programe studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm.

Referuar nivelit 5 të KSHK-së, sugjerohet që fjala “universitete” duhet zëvendësuar me fjalën “IAL”.

Këtë propozim e ka bërë edhe Nora.

Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Kërkohet vetëm harmonizimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te neni 5 nuk ka komente. Te neni 6 nuk ka komente. Komentet për nenin 7 sapo i lexuam. Te neni 8 nuk ka komente.

Neni 9, propozohet të ndryshohet në bazë të nenit 8 të ligjit bazë. Nga Komisioni i Ligjeve janë bërë disa rekomandime, që lidhen me faktin që ministrinë janë organe që hartojnë dhe miratojnë politika dhe mbikëqyrin, dhe nuk këshillojnë. Këshillimi nuk është detyrë e ministrisë dhe ne e kemi ndryshuar këtë nen.

Te pika “dh”, e pikës 3, të këtij neni raportimi periodik në KM për çështje që lidhen me KSHK-në, shprehja “Procedurat për miratimin e regjistrimit të kualifikimeve profesionale...”

sugjerohet të hiqet, pasi është përsëritje e fjalisë së dytë të kësaj shkronje. Fjala e dytë e kësaj shkronje sugjerohet të riformulohet si më poshtë: “Procedurat për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale të nënsektorit të arsimit dhe të formimit profesional përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.”

Në funksion të qartësimit të kompetencave të ministrive përgjegjëse dhe ndarjes së qartë me kompetencat e agjencive dhe institucioneve zbatuese të parashikuara nga neni 11 i projektligjit, sugjerohet që pas shkronjës “e” të shtohen dy nënparagrafë me këtë përmbajtje: “Hartimi dhe propozimi i bazës ligjore dhe nënligjore në fushën e kornizës shqiptare të kualifikimeve;”

“f- kryerjen e rishikimeve të kriterëve të procedurave për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve që përfshihen në kornizën shqiptare të kualifikimeve, kryesisht ose bazuar në propozimet për ndryshime të institucioneve apo agjencive të varësisë”.

Jeni dakord me këto ndryshime në nenin 9?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te neni 10 nuk ka ndryshime, sepse vetëm shfuqizohet për harmonizim.

Neni 11, që ndryshon nenin 10 të ligjit bazë.

Edhe këtu, duke u marrë në konsideratë që, ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar kompetencat e institucioneve të arsimit të lartë vetëm në kuadrin e ofrimit të arsimit të lartë dhe zhvillimit të veprimtarisë shkencore, sugjerohet riformulimin i germës “b”, të pikës 1, si më poshtë:

“b) institucionet e arsimit të lartë, bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse për punësimin dhe aftësinë, për kryerjen e vlerësimeve periodike të tregut të punës dhe punësimit të të diplomuarve;”.

Në paragrafin 6, të pikës 1 sugjerohet, që termi “validimin” të zëvendësohet me termin “vlefshmërinë”.

Nënparagrafët “ii” dhe “iv” të shkronjës “c” sugjerojmë të hiqen nga ky nen, duke marrë në konsideratë kompetencat e ministrive dhe agjencive/institucioneve të varësisë, referuar legjislacionit në fuqi për administratën shtetërore. Në këtë aspekt, është bërë propozimi përkatës për të shtuar germat “ë” dhe “f” në nenin 9, pika 3 të projektligjit.

Jeni dakord me këto ndryshime?

Po i ndiqni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 12, që ndryshon nenin 11 të ligjit bazë.

Në pikën 1 të këtij neni shprehja “të kompanive lider në sektorët përkatës”, sugjerojmë të zëvendësohet me shprehjen “përfaqësues të biznesit”.

Pika 5 sugjerohet të ndryshohet si më poshtë: “Mënyra e organizimit, funksionimit, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyra e shpërblimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.” Kjo ishte për nenin 12.

Në fakt, për nenin 11 ka edhe një propozim nga Nora, lidhur me emërtimin “komitete dhe komisione”. Nora propozon që komitetet sektoriale që zëvendësojnë këshillin në ligjin që amendohet, duhen mbështetur nga ministritë përkatëse me burime njerëzore dhe financiare, në mënyrë që korniza të vihet në jetë realisht.

A janë bërë këto ndryshime në tekst?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Linda Pustina – Ne tani e morëm këtë sugjerim dhe në fakt, kjo është pjesë e VKM-së që do të dalë për ngritjen e komiteteve sektoriale, që po asistohet ETF-ja (*European Training Foundation*). Ne do ta marrim parasysh. Kjo ishte një nga çështjet që ne i kemi diskutuar paraprakisht, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

... është e përcaktuar në nenin e fundit, te pika 5, që thotë: “Ngritja e komiteteve sektoriale, mënyra e funksionimit përcaktohet me VKM.”

Çështja që mendoj se i referohet zonja Malaj, ka lidhje me ngritjen e çdo komiteti sektorial. Këtu është e parashikuar që bëhet me VKM.

Ndoshta sugjerimi është që të bëhet me urdhër të përbashkët.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, mund të bëj një propozim që edhe dispozitave kalimtare t’u shikojmë peridiocitetin, që u kemi vënë në fund të ligjit.

Për sa kohë jeni gati për nxjerrjen e akteve nënligjore?

Linda Pustina – Për 9 muaj.

Milva Ekonomi – Dakord.

Edhe Nora ka propozuar të jenë gati për 9 muaj.

Linda Pustina – 9 muaj është një afat i arsyeshëm për ne.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, ka propozuar që këto të dyja të bëhen me udhëzim të ministrave përkatës.

Linda Pustina – Kjo është edhe më fleksibël dhe mendoj se mund ta ndryshojmë këtë pikë dhe të themi që “do të bëhet me urdhër të përbashkët të ministrave përkatës”.

Pra, pika 1 ...

Milva Ekonomi – Pra, ky ishte propozimi i Norës për pikën 1. Jeni dakord me propozimin e Norës?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni!

Shezai Rrokaj – Te propozimet që ka bërë Komisioni i Ligjeve për komisionin përgjegjës do të shtoja, te përbërja e komiteteve sektoriale, te pika 1, “nuk marrin pjesë përfaqësuesit nga organizatat sindikale”. Kjo është edhe te ligji i vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqë mora fjalën unë mbështes propozimin e Komisionit të Ligjeve, që të ketë përfaqësues nga organizatat sindikale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Punëmarrësi mund të jetë edhe një njeri dhe nuk është fare sindikatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqenëse mora fjalën, unë mbështes propozimin e Komisionit të Ligjeve që përfaqësuesit të jenë nga sindikatat, sepse po the punëmarrës, në Shqipëri, ndodh që ka punëmarrës pa sindikata.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ka edhe ligji, edhe rekomandimet e Komisionit të Ligjeve. Nuk e di se në çfarë prizmi e keni parë.

Milva Ekonomi – Komisioni i Ligjeve ka thënë këtë për nenin 12: “Mënyra e organizimit, funksionimit, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyra e shpërblimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për formimin profesional”.

Tani, po të bëhet...

Ismet Beqiraj – Por thotë edhe këtë: “Përbërja me përfaqësues të ministrive e të tjerë”, si dhe “të punëdhënësve dhe punëmarrësve” dhe e ka hequr këtë, që është te ligji ekzistues *(ndërrhyrje pa mikrofon)*.

Milva Ekonomi – Po pra, ti kërkon që...?

Të lutem, Linda, sqaroje pak.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Ervin Demo – Atëherë, në qoftë se...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka nevojë të shtohet, por vetëm të ndryshohet emërtesa. Do të heqim fjalët “shoqatat e punëmarrësve” dhe do të vendosim “sindikatat”. Në qoftë se doni të përdorim atë, nuk ka ndonjë problem, pasi për ne është e njëjta gjë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se doni të ndryshojmë terminologjinë, e ndryshojmë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ismet Beqiraj – Ja si e ke te ligji ekzistues: “Dy përfaqësues të sindikatave, propozuar nga Këshilli Kombëtar i Punës” dhe është më korrekte.

Milva Ekonomi – Prandaj është bërë ndryshimi. Sqaroje pak, Linda.

Linda Pustina – Atëherë, ju lutem, mënyra e shkrimit të këtij neni është sugjeruar nga ETF-ja. Në këto kushte, ne kemi lënë fjalët “shoqatat e punëmarrësve”. Megjithatë, që të mos debatojmë në infinit, mendimi ynë ka qenë për sindikatat dhe, në fakt, shoqatat e punëmarrësve janë sindikatat. Nëse ju e konsideroni fundamentale këtë ndërrhyrje, ne shprehemi dakord që fjalët “shoqatat e punëmarrësve” t’i zëvendësojmë me fjalën “sindikatat”. Nuk ka asnjë lloj problemi.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Jo, ndërkohë regjistrohet sindikata, por edhe shoqata regjistrohet. Sindikata lufton për orarin e punës, për pagat, për kualifikimet, pra nuk e ka në qendër vetëm kualifikimin. Ma do mendja se shoqata...

Shezai Rrokaj – Termi “shoqatë” është më gjithëpërfshirës.

Milva Ekonomi – Po, më përfshirës, sepse...

(Diskutime në sallë pa mikrofon.)

Linda Pustina – Nuk ishte kjo arsyeja.

Shezai Rrokaj – Unë mendoj të ruhen termat “shoqatat e punëdhënësve” dhe “shoqatat e punëmarrësve”, që janë sindikatat e thëna në një formë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – ...në kuptimin që i jep Nora, sepse këta e kanë vënë këtu “me vendim të Këshillit të Ministrave” çështjen e pagesës. Nuk e di si është nga teknika legjislative, por, po të dalë me një urdhër të përbashkët ministrash, a paguhen dot njerëzit?

Linda Pustina – Pika 5 parashikon mënyrën e ngritjes, funksionimit dhe shpërblimit. Pra, VKM-ja kuadër është e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Sugjerimi i referohet pikës 1. Pra, pasi ngrihet një VKM kuadër, çdo komitet sektorial ngrihet rast pas rasti.

Milva Ekonomi – Në rregull.

Linda Pustina – Sepse nuk ngrihen të gjitha në bllok.

Pastaj, rast pas rasti, komiteti sektorial është parashikuar të ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave, që, në fakt, e koklavit disi situatën. Alternativa është të ngrihet me urdhër të përbashkët të të dy ministrave dhe ka lidhje vetëm me përbërjen.

Milva Ekonomi – Lehtëson punën, bëhet më...

Linda Pustina – Lehtëson punën, ndërsa e gjithë pjesa, përfshirë shpërblimet, është kuadër dhe ka një vendim të Këshillit të Ministrave për atë gjë.

Milva Ekonomi – Biem dakord?

Linda Pustina – Ne shprehemi dakord me propozimin që këto mund të ngrihen edhe me urdhër të përbashkët, pasi është më fleksibël.

Milva Ekonomi – Biem dakord me propozimin?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, neni 12 miratohet me ndryshimet që bëri Nora, duke lënë të hapur që sindikatat do të jenë të përfshira tek termi “shoqatë”.

Për sa i përket nenit 13, i cili ndryshon nenin 12 të ligjit bazë, nuk ka rekomandime ose sugjerime nga ne.

Viojmë me nenin 14.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Biem dakord me nenin 13, siç është? Në rregull.

Në nenin 14, që ndryshon nenin 13 të ligjit bazë, pas fjalës “procedurat” sugjerohet të shtohet fjala “rregullat”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thuhet: “Akreditimi i programeve të studimit të kualifikimeve përkatëse kryhet në përputhje me procedurat, rregullat dhe specifikimet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si e kemi, “Rregullat, procedurat dhe specifikimet”?

Shezai Rrokaj – Një sekondë, se procedura ka të bëjë me mënyrën se si rrjedh procesi, por procesi pa rregullin nuk mund të qëndrojë. Prandaj, ose duhet lënë fjala “rregullave”, ose “procedurave”.

Milva Ekonomi – Ato propozojnë që të jetë fjala “rregullave”.

Shezai Rrokaj – Këto shkojnë kështu... Janë terma që tërheqin njëri-tjetrin në një mënyrë të foluri, por janë terma që fërkohen me njëri-tjetrin, sepse procedurat nuk mund të jenë pa rregulla.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po vumë fjalën “rregullat”, është në rregull.

Milva Ekonomi – Këto e kanë lënë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shezai Rrokaj – Procedura për mua është term më i...

Milva Ekonomi – E kanë lënë të gjithë si bllok: “Rregullat, procedurat dhe specifikimet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shezai Rrokaj – Janë terma që tërheqin njëri-tjetrin në një...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – E lëmë kështu? Si thoni?

Linda Pustina – Për ne është në rregull, edhe po të shtohet fjala “rregullat”, nuk ndryshon asgjë.

Shezai Rrokaj – Jo, po të mbetej, do të ishte “procedurat”.

Linda Pustina – Në qoftë se duhet lënë një term, është “procedurat”. Në qoftë se jeni të mendimit të shtojmë fjalën “rregullat” dhe të mbetet togfjalëshi “rregullat dhe procedurat”, biem përsëri dakord.

Milva Ekonomi – “Rregullat, procedurat dhe specifikimet”, e kanë lënë si togfjalësh.

Shezai Rrokaj – Atëherë, lëreni kështu.

Linda Pustina – Edhe specifikimet, në rregull.

Milva Ekonomi – Biem dakord me nenin 14?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Vazhdojmë me nenin 15, që ndryshon nenin 14 të ligjit bazë. Sugjerohet që pika 1 e nenit 14 të ligjit aktual, për shkak se në këshill parashikohet të pushojë së funksionuari, sipas këtij projektligji, të riformulohet në tërësi si më poshtë: “Ministria përgjegjëse për menaxhimin e KSHK-së për arsimin dhe formimin profesional miraton politikat përbërëse për vlerësimin dhe certifikimin në fushën e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional”.

Biem dakord të formulohet kështu?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Për nenin 16 nuk ka sugjerime, as nga zonja Malaj.

Për nenin 17, që ndryshon nenin 16 të ligjit aktual, nuk ka sugjerime. Ne duhet të bëjmë kujdes tek afati për nxjerrjen e akteve nënligjore. Ku e kemi të përcaktuar afatin për aktet nënligjore?

Shezai Rrokaj – Besoj se kjo duhet të jetë te dispozitat në fund, si rregull.

Milva Ekonomi – Te cili nen?

Linda Pustina – Është te dispozitat e fundit.

Milva Ekonomi – Nuk ka këtu, prandaj pyeta.

Linda Pustina – Nuk është i parashikuar afati. Pra, është parashikuar nxjerrja e akteve nënligjore...

Milva Ekonomi – Pra, duhet shtuar.

Linda Pustina – Po, duhet shtuar “brenda nëntë muajsh”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Te neni 17? Atëherë, duhet të shtojmë një pikë 4.

Shezai Rrokaj – Mirë, por afati, për sa kohë?

Linda Pustina – Në pikat 2 dhe 3 duhen shënuar fjalët “brenda nëntë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

Shezai Rrokaj – Atëherë, të bëhet shtesa “brenda nëntë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit”.

Milva Ekonomi – Biem dakord?

Linda Pustina – Shprehemi dakord.

Milva Ekonomi – A jeni të gatshëm që brenda nëntë muajve ta mbaroni këtë?

Linda Pustina – Po, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Domethënë, në pikën 3 do të shtojmë fjalët “brenda nëntë muajve”?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka komente të tjera për ligjin?

Biem dakord ta votojmë projektligjin, me ndryshimet e bëra sipas propozimit të Komisionit të Ligjeve dhe komenteve të zonjës Malaj?

Shezai Rrokaj – Atëherë, meqenëse propozimet e koleges Malaj u morën parasysh, e votoj pozitivisht kalimin e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Tani, a ta hedhim në votë projektligjin?

Biem dakord ta përgatisim relacionin për...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, shtojca: zëvendësohet me shtojcën 1.

Neni 18. Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Neni 19. Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Biem dakord ta votojmë projektligjin në tërësi?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Në rregull.

Faleminderit!

Relatore kemi caktuar zonjat Vilma Bello dhe Nora Malaj.

Para se ta mbyll mbledhjen, dua të falënderoj shumë përfaqësuesit e Ministrisë: zotin Demo, zonjat Pustina dhe Gishti, si dhe përfaqësuesit e sindikatës për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre!

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA